



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

Për :	Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut Qash Balaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 15/08/2019 Nr. 0-882
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Jeton Qela, U. D Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore Komunale për Transparencë Nr.6/2019
E miratuar më datë: 30.07.2019
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.08.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Rregullore Komunale për Transparencë Nr.6/2019	Neni 4 paragrafi 8 dhe neni 18 paragrafi 1 i Rregullores për transparencë Nr.06/2019 të komunës se Istogut nuk është në harmoni me njëra-tjetrën lidhur me publikimin e akteve të komunës duke përcaktuar afate të ndryshme “tetë (8) ditë pas konfirmimit nga MAPL, përkatësisht shatë (7) ditë pune pas konfirmimit të ligjshmërisë”. Sipas Rregullores Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale në nenin 17 paragrafi 1 ka përcaktuar se “Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shtate (7) ditë pas publikimit të aktit në web faqen zyrtare të komunës, përveç nëse me vete aktin nuk është përcaktuar ndryshe”. Neni 5 paragrafi 2 i Rregullores për transparencë Nr. 06/2019 të komunës se Istogut nuk është në harmoni me neni 4 paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.04./2018 për transparencë në komuna , ku ka përcaktuar se Mbledhjet e Kuvendit komunal dhe Komitetit për Politike dhe financa,nëpërmes zyrës/ zyrtarit të informimit njofton publikun 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune për mbledhjet jashtëzakonshme. Neni 6 paragrafi 7 i Rregullores për transparencë të komunës se Istogut ka përcaktuar se njoftimi i palës për çështjen e peticionit bëhet “6 (gjashtë) javë nga dita e prezantimi në kuvend”. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2018 për transparencë në Komuna për këtë çështje në nenin 9 paragrafin 5 ka përcaktuar se “Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit”. Neni 7 paragrafi 10 i Rregullores për transparencë nga komuna e Istogut , se

	njoftimi për takime me publikun bëhet 4 ditë para mbajtjes nuk është në harmoni me neni 10 paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2018 për transparencë në Komuna i cili ka përcaktuar, se njoftimi për takime me qytetare bëhet(2) dy javë para mbajtjes së takimit
--	---

	Neni 27 paragrafi 3 i Rregullores për transparencë nga komuna e Istogu , nuk është në harmoni me neni 12 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, i cili ka përcaktuar se Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë.
--	--

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Haki Rugova, gradonačelnik opštine Istog Hazbi Bajra, predsedavajući Skupštine opštine Istog	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u	
Od:	Xhevat tafa v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 15.08.2019. Br. 0-882
Odgovorni službenici:	Jeton Qela, v.d. rukovodioca Odseka za monitorisanje opština Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
1. Službenik za potvrđivanje pravne procene		
2. Službenik za izradu pravne procene:		
Predmet:	Zahtev za reviziju akta opštine Istog	
Vrsta akta:	Pravilnik Skupštine opštine Istog	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Opštinski pravilnik za transparentnost br.6/2019
Usvojena dana, 30.07.2019. godine
Predložena na razmatranje MALS-u dana, 07.08.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog sadržaja akta opštine, procenjuje da se opštinski akt ne zasniva na odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku ćete naći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

Br.	Formulisane u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.
1.	Opštinski Pravilnik o transparentnosti br.6/2019	Član 4. stav 8 i član 18. stav 1 Pravilnika o transparentnosti br.06/2019 opštine Istog nije u skladu jedni sa drugim u vezi sa objavljivanjem opštinskih akata određujući razne rokove "osam (8) dana nakon potvrđivanja od strane MALS-a, odnosno "sedam (7) radnih dana nakon ozvrđivanja zakonitosti". Prema Pravilniku br.01/2017 o procedurama izrade i objavljivanja opštinskih akata, u članu 17, stav 1, je definisali da: "Opštinski normativni akti stupaju na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja akata na webstranici opštine, osim ako sa istim aktom nije drugačije definisano". Član 5. stav 2 Pravilnika o transparentnosti br. 06/2019 opštine Istog nije u skladu sa članom 4, stavom 3, Administrativnog uputstva br. 04.L-2018 o transparentnosti u opštinama, gde je definisano da: za sednice Skupštine opštine i Odbora za politiku i finansije, putem kancelarije službenika za informisanje, obaveštava se javnost sedam (7) radnih dana pre održavanja redovnih sednica i tri (3) radna dana pre održavanja vanrednih sednica. Član 6. stav 7, Pravilnika o transparentnosti opštine Istog, definisao je da: obaveštenje stranke o pitanju peticije se objavljuje "šest (6) nedelje od dana prezentacije u skupštini". Prema Administrativnom uputstvu br.04/2018 o transparentnosti u opštinama, za ovo pitanje u članu 9, stavu 5, definisano je da: "nakon rasprave u Skupštini opštine, gradonačelnik opštine ili dotična služba, najkasnije u roku od petnaest (15) dana od dana razmatranja pismenim putem obavešta podnosioca zahteva". Član 7. stav 10, Pravilnika o transparentnosti opštine Istog da: obaveštanje o javnom skupu sa objavljuje četiri (4) dana pre održavanja istog nije u skladu sa članom 10, stavom 4, Administrativnog uputstva br.04/2018 o

		transparentnosti u opštinama koji j definisao da: se obaveštenje za skup sa građanima treba da se objavljuje dve (2) nedelje pre održavanja skupa Član 27. stav 3, Pravilnika o transparentnosti u opštini Istog, nije u skaldu sa članom 12, stavom 1, Zakona br. 06/L-081 o pristupu u javnim dokumentima koji j definisao da: javna institucija se obavezuje da u roku od sedam (7) dana, od dana registrovanja zahteva, donosi odluku za pristup u traženi dokument ili da donosi odluku za obrazloženje o potpunom ili delimičnom odbijanju i informiše podnosioca zahteva o pravu koje treba da zahteva, kada i gde se takav zahtev podnosi,.
--	--	--

Iz gore navedenog, Ministarstvo adminisracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine Istog traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile za zakonskim odredbama na snazi i u vremanskom roku od 30 dana, od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta opštine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Sanije Dërguti

From: Nazmije G.Krasniqi
Sent: Thursday, August 15, 2019 11:17 AM
To: Sanije Dërguti
Cc: Diellor Gashi; Xhevat Tafa; Jeton Qela
Subject: FW: Rregullore komunale Nr.5/2019 për orarin e punës për subjektet afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese në komunën e Istogut
Attachments: 0-882-2019.pdf

Sanije

Me poshtë keni vlerësimin e Rregullores për transparencë dhe Planin e veprimit për transparencë nga Komuna e Istogut

Në vijmë ;

Divizioni për transparencë ka vlerësuar Rregulloren për transparencë të komunës së Istogu dhe Planin e veprimit për transparencë , duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2018 për transparencë në komuna , Rregulloren Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale si dhe Ligjin për qasje në dokumente publike, bazë të cilit e bëjmë edhe vlerësimin në fushën e transparencës , ku dhe konstaton se ;

Neni 4 paragrafi 8 dhe neni 18 paragrafi 1 i Rregullores për transparencë Nr.06/2019 të komunës se Istogut nuk është në harmoni me njëra-tjetrën lidhur me publikimin e akteve të komunës duke përcaktuar afate të ndryshme *“tetë (8) ditë pas konfirmimit nga MAPL, përkatësisht shatë (7) ditë pune pas konfirmimit të ligjshmërisë”*. Sipas Rregullores Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale në nenin 17 paragrafi 1 ka përcaktuar se *“Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shtate (7) ditë pas publikimit të aktit në web faqen zyrtare të komunës, përveç nëse me vete aktin nuk është përcaktuar ndryshe”*.

Neni 5 paragrafi 2 i Rregullores për transparencë Nr. 06/2019 të komunës se Istogut nuk është në harmoni me neni 4 paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.04./2018 për transparencë në komuna , ku ka përcaktuar se Mbledhjet e Kuvendit komunal dhe Komitetit për Politike dhe financa,nëpërmes zyrës/zyrtarit të informimit njofton publikun 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune për mbledhjet jashtëzakonshme

Neni 6 paragrafi 7 i Rregullores për transparencë të komunës se Istogut ka përcaktuar se njoftimi i palës për çështjen e peticionit bëhet *“6 (gjashtë) javë nga dita e prezantimi në kuvend”*. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2018 për transparencë në Komuna për këtë çështje në nenin 9 paragrafin 5 ka përcaktuar se *“Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit”*.

Neni 7 paragrafi 10 i Rregullores për transparencë nga komuna e Istogut , se njoftimi për takime me publikun bëhet 4 ditë para mbajtjes nuk është në harmoni me neni 10 paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2018 për transparencë në Komuna i cili ka përcaktuar, se njoftimi për takime me qytetare bëhet(2) dy javë para mbajtjes së takimit

Neni 27 paragrafi 3 i Rregullores për transparencë nga komuna e Istogu , nuk është në harmoni me neni 12 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, i cili ka përcaktuar se Institucioni

publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë.

Ndërsa Plani i veprimit për transparencë 2019 -2023 nga Komuna e Istogut është në pajtueshmëri me draft planin e hartuar nga MAPL dhe i plotëson kriteret e përcaktuar me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2018, për transparencë në komuna, dhe njëti mundet të procedohet në kuvendin komunal për miratim .

From: Sanije Dërguti

Sent: 2019-08-08 10:22.PD

To: Nazmije G.Krasniqi

Cc: Jeton Qela

Subject: FW: Rregullore komunale Nr.5/2019 për orarin e punës për subjektet afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese në komunën e Istogut

E nderuar,

Gjeni te bashkangjitur Rregulloren e Komunës se Istogut për vlerësim te ligjshmërisë.

Me respekt,

Sanija

From: Shkrimorja Mapl

Sent: Thursday, August 08, 2019 10:01 AM

To: Xhevat Tafa; Jeton Qela; Sanije Dërguti

Subject: Rregullore komunale Nr.5/2019 për orarin e punës për subjektet afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese në komunën e Istogut



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



04.08.2019



Komuna e Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

01 Numër: 95/2019
Data: 30.07.2019

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Rregullore Komunale Nr. 6/2019

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Istogut		
Kommune Istok		
Municipality of Istog		
04.08.2019		
Titull	Emri i Komitetit	Emri i Komitetit
Titull	Emri i Komitetit	Emri i Komitetit

RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

Istog-Korrik/2019

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.1 pika c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika a) e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), në bazë të dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 04/2018 për Transparencën në Komunë, dhe në bazë të dispozitave të UA MAPL Nr.06/2018, Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë, dhe neneve 33 paragrafi 1 dhe neni 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01nr.62/2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 30.07.2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSPARENCË

1. DISPOZITATE PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Më këtë Rregullore synohet që të arrihet:

1. Forcimi i transparencës në punë të organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal;
2. Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente publike.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si më poshtë:
2. "Mbledhjet e Kuvendit të Komunës" - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit;
3. "Komitetet" - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësi të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;

4. "Pjesëmarrja e publikut" - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje;
5. "Njoftimi i publikut" - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetën e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;
6. "Tubime publike" - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës – drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;
7. "Petitioni" - nënkupton kërkesën që i adresohet Komunës nga përgjegjësit e saj;
8. "Konsultim publik i akteve komunale" - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;
9. "Qasja në dokumentet publike"- nënkupton shikimin e dokumenteve publike të Komunës, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrtarit për marrëdhënie me publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente brenda ditës.
3. Njoftimi publik bëhet përmes:
 - 3.1 mediave të shkruara dhe elektronike dhe
 - 3.2 ueb-faqes së Komunës.
4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
6. Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet publike, duhet të bëhen publike tetë (8) ditë pas konfirmimit të ligjshmërisë së tij.
7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Istogut.
8. Transmetimi në ueb faqe të komunës i seancave të KK në bazë të UA Nr.01/2019 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative "tele prezencave".

Neni 5

Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera

1. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e merr kryesuesi i mbledhjes.

2.1 Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 2 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

2.2 Të gjitha propozimet e komiteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet publike, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

Neni 6

Peticioni

1. Secili qytetar dhe personi juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetëiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës marrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
2. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
 - 2.1 rregullimin e qytetit,
 - 2.2 mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
 - 2.3 urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
 - 2.4 mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
 - 2.5 zbatimin e vetëkontrollit dhe
 - 2.6 çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.
3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.
4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
5. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të çeket qartë në secilën faqe. Komitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është çekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e dhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.
6. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon

çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.

7. Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.

Neni 7

Takimet me publikun

1. Komuna/Kryetari mban së paku dy takime publike me qytetarë për çështje të interesit publik.
2. Njëri nga takimet publike duhet të mbahet në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit, ndërkohë tjetri mbahet në gjashtë (6) mujorin e dytë të vitit.
3. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
4. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
5. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
6. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativë, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
7. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
8. Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
9. Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.
10. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën-at e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë 4 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me publikun.
11. Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.
12. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevojë, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e parapare për diskutim.
13. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.

14. Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.
15. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e rradhës.

Neni 8

Konsultimi publik i akteve komunale

1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:
 - 2.1 ueb faqes zyrtare të Komunës në internet,
 - 2.2 mediave të shkruar dhe elektronike,
 - 2.3 shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës
3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 1 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.
4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.
5. Propozimet e dhëna nga publiku gj.
6. atë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.
7. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

Neni 9

Caktimi i zyrtarit përgjegjës

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njësis/zzyrtari për komunikim publik.

Neni 10

Parimet e konsultimit publik

1. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:

1.1. **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;

1.2. **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare;

1.3. **Barazisë dhe mosdiskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jo diskriminuese në procesin e konsultimit publik;

1.4. **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave me të përshtatshme për të kuptuar me lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt- propozimeve.

Neni 11

Dokumentet për konsultim publik

1. Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave të qeverisjes lokale si në vijim:

1.1. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;

1.2. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;

1.3. Strategjitë zhvillimore dhe Planet e veprimit në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale;

1.4. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;

1.6. Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.

1.7. Çfaredo dokumenti tjetër të parapare në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

Neni 12

Format dhe teknikat e konsultimit publik

Publikimet vendosen edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si vegëse në ueb-faqen zyrtare të komunës;

Neni 13

Planifikimi i konsultimeve publike

Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

Neni 14

Zbatimi i standardeve të konsultimit publik

1. Komuna bënë publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror.
2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.
3. Komuna për politikën e caktuar të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të sigurojë konsultimin në fazat e hershme të hartimit palot e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes.
4. Komuna është e obliguar të shpallë rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikojë raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të japë sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara;

Neni 15

Aktet nënligjore të komunës për konsultim publik

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
 - 1.1 Draft-Statuti i Komunës;
 - 1.2 Projekt-rregulloret Komunale;
 - 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale;

Neni 16

Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik

- 1 Kryetari i komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
- 2 Kuvendi i komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Neni 17

Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi

Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mire/Zyra e

Kryeministrit dhe për ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve komunal për konsultim publik.

Neni 18

Transparenca e vendimeve të organeve të komunës

1. Publikimi në faqen zyrtare të komunës i akteve normative të komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm në afat prej 7 ditë pune nga konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit.
2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësi/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës.

Neni 19

Transparenca për shpenzime buxhetore

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të komunës.
2. Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës;
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial;
4. Komiza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës;
5. Raporti përmblledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial;
6. Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Neni 20

Transparenca në aktivitetet e prokurimit

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

Neni 21

Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike

1. Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si:

- 1.1 Planin e punës së kryetarit dhe kuvendit të komunës;
- 1.2 Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara;
- 1.3 Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane;
- 1.4 Raportin vjetor të punës së kryetarit dhe kuvendit;
- 1.5 Procesverbalet e takimit të kuvendit të komunës dhe komiteteve obligative;
